



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC**

Nr. \_\_\_\_ .Prot

Pogradec më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**Lënda: Përgjigje mbi informacionin e kërkuar nga Qendra “Res Publica”**

Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Në lidhje me konstatimet e kundërvajtjeve

Gjatë periudhës së kërkuar nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Pogradec, janë konstatuar gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) raste kundërvajtjesh, të evidentuara sipas procedurave ligjore në fuqi.

Në lidhje me masat administrative të marra

Për kundërvajtjet e konstatuara janë marrë 15 (pesëmbëdhjetë) masa administrative me gjobë, si dhe janë vendosur 11 (njëmbëdhjetë) masa për prishje objekti, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në lidhje me ekzekutimin dhe ankimimin e vendimeve

Nga masat e vendosura, janë ekzekutuar 3 (tre) vendime. Sa i përket ankimimeve, shumica e vendimeve janë ankimuar nga subjektet përkatëse, por aktualisht nuk disponohet një numër i saktë i ankimimeve, për shkak të procesit në vijim dhe regjistrimeve ende të papërditësuara.

Shpresojmë që informacioni i mësipërm t’i shërbejë qëllimit të kërkesës suaj.

Për çdo sqarim shtesë, mbetemi në dispozicion.

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)